

Bazuar në nenin 11 të Udhëzimit Administrativ – Aktivitetet jashtëshkollore nr. 02/2016 të dt. 12.01.2016, vendimin nr. 133/2025 të datës 26.02.2025 nga KDSH, drejtoria e gjmnazit “Remzi Ademaj” në Prizren, shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të gjmnazit “Remzi Ademaj” në Prizren

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të gjmnazit “Remzi Ademaj” nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë më datën 06.05.2025 deri më 10.05.2025.

Paraqitësit në tender duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Certifikata e agjencionit transportues
- Të ketë bërë kontrollin teknik sipas procedurave ligjore,
- Fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore,
- Certifikata e autobusit sipas licencës D
- Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës mbi 300 vende
- Autobusët të jenë komforë dhe me klimë,
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi, certifikatë pune me diplomë të mjekut që shoqëron nxënësit.
- Dëshmi për rezervimin e hotelit për datën 06.05.2025 deri më 10.05.2025.
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve.
- Certifikatat e shoferëve (CPC)
- Referencat rreth organizmit të ekskursionit përcaktuar nga KDSH
- Certifikatën e biznesit me informata për biznesin,
- Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë
- Të prezantohet ambienti (komoditeti) së paku me foto i Hotelit nr.telefonit i pronarit dhe adresa të përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë mbi 300 shtretër. Të posedojë rrethojë dhe i siguruar nga personeli i sigurimit të hotelit për të garantuar siguri për nxënës përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë sallën e ushqimit me hapsirë të mjaftueshme mbi 300 vende për ushqim në tri vaktet kriter i përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë sallë për argëtim së paku për 300 nxënës dhe të mos shërbehen pije alkoolike për nxënës përcaktuar nga KDSH Sistemimi i nxënësve në dhoma të jetë jo më shumë se katër nxënës përcaktuar nga KDSH.
- Gjatë vizitave nëpër monumente pagesa për nxënës të sigurohet nga kompania përcaktuar nga KDSH
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion përcaktuar nga KDSH
- Agjencioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tre vitet e fundit, përcaktuar nga KDSH
- Lartësia e pagesës 145 euro përcaktuar nga KDSH

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimeve mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit në Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë nga data 04.03.2025 deri më 10.03.2025. Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 me datë 10.03.2025 në ora 17:00 në ambientet e DKA Prizren ku mund të marrin pjesë edhe ofertuesit.

Pas hapjes se ofertave, komisioni do të verifikojë dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga kompanitë, ku dhe do të bëhet vlerësimi.

Fituesi i ofertës për organizimin e ekskursionit do të jetë kompania turistike e përgjegjshme me çmimin më të ulët të ofertës.

Drejtoria e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.